

VENDIM
Nr.426, datë 2.7.2004

PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E “ARMO” SHA FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9117, datë 24.7.2003 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të “Armo” sh.a., Fier, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimi i ofertave të detyrueshme, që do të paraqiten nga investitorët strategjikë, të cilëve u ofrohet paketa e aksioneve të kapitalit të “Armo” sh.a., Fier dhe përcaktimi i pikëve të vlerësimit të ofertave të kryhen sipas kriterëve të përcaktuara në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

TABELA E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E “ARMO” SHA

	Totali	Pjesë
1. Kredencialet e blerësit & Aftësia teknike	100	
1.1 Interesi strategjik		50
1.2 Aftësitë teknike		50
2. Plani i biznesit	100	
2.1 Rritja e kapacitetit përpunues deri në kapacitetin optimal të projektit, mbi 2500 ton/ditë	20	
2.2 Ndërhyrjet në nyjet më të ngushta të KPTHN, Ballsh	20	
2.2.1 Prodhimi i benzinave me nr.Oktati të lartë mbi 95		10
2.2.2 Prodhimi i squfurit dhe ambalazhimi i tij sipas standardit europian		5
2.2.3 Automatizimi i procesit për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe uljen e normativave të lëndëve ndihmëse		5
2.3 Ndërhyrjet në teknologji për përmirësimin e kushteve të mjedisit me KPTH Ballsh, UP Fier, si dhe në përpunimin e mbetjeve teknologjike në përputhje me standardet hidrosanitare	10	
2.4 Rehabilitimi i ujësjellësit Poçem-UPTHN, Ballsh	10	
2.5 Rehabilitimi i TEC-it, Ballsh për prodhimin e energjisë elektrike	20	
2.6 Aspektet ekonomike financiare	10	
2.6.1 Huatë e marra për zhvillim		5
2.6.2 Masat për rastet e vështirësive që mund të lindin		5
2.7. Të tjera	10	
2.7.1 Plani i investimit		
3. Oferta financiare	800	
3.1 Vlerësimi		
3.1.1 Çmimi		800